

## Mbi çregjistrimin e subjekteve tatimore

Personat e regjistruar në organin tatimor mund të çregjistrohen në rastet që vijojnë:

- personat fizikë dhe juridikë, sipas dispozitave të ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
  - organizatat jofitimprurëse, në bazë të vendimit të gjykatës;
  - përfaqësuesi tatimor, me përmbushjen e detyrimit tatimor si i tillë;
  - personat të cilët, sipas ligjit për falimentimin, janë shpallur të falimentuar me vendim gjykate të formës së prerë;
  - personat juridike publikë, në përputhje me legjislacionin e fushës që përcakton veprimtarinë e tyre;
- ❖ Datë e çregjistrimit të tatimpaguesit në administratën tatimore do të konsiderohet data e çregjistrimit në QKB ose gjykatë. Datë e çregjistrimit të personave të vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi ambulant, të kryefamiljarit, që punëson individë si punëtorë shtëpie, kujdestare etj. të kësaj natyre, të përfaqësuesve tatimorë dhe fermerit është data e miratimit të çregjistrimit të tyre nga administrata tatimore, por me efekt në datën e paraqitjes së kërkesës për çregjistrim.
- ❖ Qendra Kombëtare e Biznesit ose gjykata, menjëherë me marrjen e kërkesës për çregjistrim prej tatimpaguesit, njofton organin tatimor kompetent për regjistrimin e hapjes së procedurave të likuidimit ose për kërkesën për çregjistrim të personit fizik apo për aplikimin për çregjistrim të personit juridik edhe kur kemi të bëjmë me aplikimin për çregjistrim pa kryerjen e likuidimit.
- ❖ Organi tatimor kompetent, brenda 10 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës për çregjistrim, sipas pikës 3, të këtij neni, është i detyruar të verifikojë situatën tatimore të subjekteve dhe njofton njëkohësisht QKB-në ose gjykatën dhe subjektin. Kur organi tatimor, sipas analizës së riskut, gjykon se është e nevojshme të ushtrojë kontroll nëmjedisin ku ushtron veprimtarinë subjekti, atëherë ky afat nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë pune, përfshirë kryerjen e kontrollit.
- ❖ Qendra Kombëtare e Biznesit ose gjykata nuk mund të kryejë çregjistrimin, në qoftë se brenda afatit 30-ditor, të përmendur në pikën 4, të këtij neni, administrata tatimore e kundërshton me shkrim çregjistrimin. Kundërshtimi i çregjistrimit të tatimpaguesit nga administrata tatimore tregon shumën e detyrimeve tatimore të papaguara të tatimpaguesit dhe, në rastin e personit juridik, faktin se ai nuk ka paraqitur pasqyrat



financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e likuidimit, ose nuk ka dorëzuar deklaratat tatimore.

- ❖ Nëse organi tatimor nuk i përgjigjet QKB-së ose gjykatës brenda afatit, QKB-ja ose gjykata çregjistron automatikisht subjektin dhe njofton në të njëjtën ditë organin tatimor dhe tatimpaguesin.

Në rastin kur subjektet e regjistruara pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ose gjykatës rezultojnë me detyrime tatimore, ato çregjistrohen automatikisht pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore, përfshirë detyrimet që lindin në rastin kur çregjistrimi kryhet me likuidim. Në momentin kur subjekti paguan detyrimet tatimore, organi tatimor menjëherë njofton QKB -në gjykatën dhe subjektin, që nuk ka detyrime tatimore të papaguara.

- ❖ Në rastin kur kundërshtimi për çregjistrim nga organet tatimore është bërë si pasojë e mosdorëzimit të pasqyrave financiare ose deklaratave tatimore, atëherë, me paraqitjen e tyre, organi tatimor kompetent detyrohet të tërheqë menjëherë kundërshtimin përçregjistrim dhe Qendra Kombëtare e Biznesit kryen menjëherë çregjistrimin e tatimpaguesit.
- ❖ Nëse, pavarësisht nga shlyerja e detyrimit, për të cilin është kundërshtuar çregjistrimi, organi tatimor kompetent nuk ka tërhequr kundërshtimin, atëherë subjekti paraqet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dokumentin që vërteton shlyerjen e këtyre detyrimeve tatimore. Në këtë rast, Qendra Kombëtare e Biznesit kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit dhe njofton menjëherë organin tatimor kompetent dhe tatimpaguesin.
- ❖ Çregjistrimi tatimor nuk eliminon detyrimet ekzistuese tatimore dhe nuk parandalon administratën tatimore të vlerësojë ose të mbledhë detyrimet tatimore.
- ❖ Për çdo procedurë që organi tatimor dhe QKB-ja kryejnë, sipas këtij neni, që kur fillon procedura e çregjistrimit dhe deri në çregjistrimin përfundimtar, njoftohen në të njëjtën kohë edhe tatimpaguesit.